



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 145

Tiranë – E premte, 6 tetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 102/2023, datën 21.9.2023.	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore.....	16071
Dekret i Presidentit nr. 276, datë 4.10.2023	Për emërimin e rektorit të Akademisë së Sigurisë.....	16071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 556, datë 4.10.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 604, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.....	16071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 557, datë 4.10.2023	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.....	16072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 558, datë 4.10.2023	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.....	16072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 4.10.2023	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 900, datë 6.12.2012, nr. 543, datë 29.9.2021, nr. 50, datë 26.1.2022, nr. 522, datë 29.7.2022, nr. 861, datë 27.12.2022, për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara.....	16074
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 4.10.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 87, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.	16081
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 4.10.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i godinave të spitalit ‘Shenja Mari’ dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen”.....	16081

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 4.10.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike të Njesisë Administrative Perondi, fshati Tapi, Kuçovë”.....	16084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 4.10.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi territorial i varrezave të fshatit Xhafzotaj”, Bashkia Shijak..	16085
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 567, datë 4.10.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 300, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit ‘Sistemim rrugësh, blloku te stadiumi, Pogradec’”.....	16086
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 4.10.2023	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si Autoritet Kontraktor për realizimin e projektit të zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit “Skënderbeu” në Korçë, përfshirë stadiumin.....	16087
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 119, datë 29.9.2023	Për miratimin e rregullores “Mbi kuadrin rregullator për hapësirën – U të hapësirës ajrore”.....	16087

**VENDIM
Nr. 102/2023****PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, nenit 24 dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 6-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miratuar në datën 21.9.2023.

**DEKRET
Nr. 276, datë 4.10.2023****PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË
AKADEMISË SË SIGURISË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g” dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pikës 7, të vendimit nr. 881, datë 28.10.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 12, datë 30.7.2023, të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të Akademisë së Sigurisë, “Për shpalljen e rezultateve

të zgjedhjeve të para për autoritetin drejtues, në pozicionin Rektor të Akademisë së Sigurisë”, me propozim të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ilirjan Mandro, emërohet rektor i Akademisë së Sigurisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**VENDIM
Nr. 556, datë 4.10.2023****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 604, DATË 20.10.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË BRENDSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “ë”, e pikës 3, të vendimit nr. 604, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 557, datë 4.10.2023****PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
PUSHTETIN VENDOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore, të lidhura me veprimtarinë e njërive të vetëqeverisjes vendore.

3. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në kuadër të fushës së përgjegjësisë së tij, ushtron këto kompetenca:

a) ndjek hartimin dhe realizimin e zbatimit të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit e të vetëqeverisjes vendore;

b) bashkërendon punën për propozimin, përmirësimin dhe hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore në fushën e decentralizimit e të vetëqeverisjes vendore, si dhe jep mendim për projektaktet që kanë të bëjnë me çështje të lidhura me njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) mbikëqyr punën për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Vetëqeverisjen Vendore, si dhe planit të veprimit përkatës;

ç) përfaqëson politikat e qeverisë në fushën e vetëqeverisjes vendore dhe koordinon punën me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë, që mbështesin zhvillimin e njërive të vetëqeverisjes vendore;

d) drejton dhe bashkërendon punën ndërmjet strukturave të ngritura në kuadrin e marrëdhënieve ndërinstitucionale me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;

dh) kujdeset për përmbushjen e detyrimeve, si dhe monitoron e koordinon masat, që rrjedhin në

kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, për sa ato kanë të bëjnë me vetëqeverisjen vendore;

e) siguron krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim monitorimin dhe zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;

ë) bashkërendon dhe mbështet punën e organeve përgjegjëse në funksion të zbatimit të politikave shtetërore në fushën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, në përputhje me legjislacionin përkatës;

f) kryen edhe funksione e veprimtari të tjera brenda fushës së përgjegjësisë, që i ngarkohen në përputhje me ligjin, marrëveshjet ndërkombëtare, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e Kryeministrit apo që nuk i janë ngarkuar specifikisht një organi apo institucioni tjetër shtetëror, por kanë të bëjnë me vetëqeverisjen vendore.

4. Ngarkohet ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 558, datë 4.10.2023****PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E
BIZNESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka për mision mbështetjen e sipërmarrjes private, vendëse dhe të huaj, që ushtron aktivitetin



në Republikën e Shqipërisë, bashkërendimin e proceseve të brendshme të institucioneve shtetërore, hartimin e politikave për lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet ndërmjetësimit dhe nismave të integruara qeveritare në këtë fushë.

3. Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) për krijimin dhe zhvillimin e *startup*-eve;

b) për mbështetjen e veprimtarisë së punonjësve lëvizës digjitalë;

c) për garantimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet administratës shtetërore dhe sektorit privat mbi zhvillimin e politikave ekonomike të dialogut, këshillimit dhe zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve.

4. Me qëllim realizimin e veprimtarisë së tij, ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit:

a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e mbështetjes së *startup*-eve;

b) koordinon zbatimin e politikave të zhvillimit të *startup*-eve, në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të sipërmarrjes në vend;

c) koordinon me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor të *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;

ç) propozon miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së biznesit dhe palëve të treta, si dhe i miraton ato për mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve;

d) vepron si organ mbështetës për *startup*-et, lehtësuesit dhe palët e treta, duke bërë të mundur tërheqjen dhe duke mbështetur alokimin e fondeve ose të granteve të donatorëve të huaj për ekosistemin në Shqipëri;

dh) bashkëpunon me institucionet vendëse, organizatat ndërkombëtare dhe me organizatat jofitimprurëse, vendëse e të huaja, për rritjen e ndërgjegjësimit publik në fushën dhe veprimtarinë e *startup*-eve, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ligji për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve;

e) kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara në ligjin për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve;

ë) bashkërendon prioritetet e politikave shtetërore dhe politikëbërjen në fushën e:

i. lehtësimit të procedurave dhe përmirësimin e klimës së biznesit;

ii. nxitjes dhe lehtësimit të investimeve vendëse dhe të huaja;

iii. veprimtarisë së institucioneve të infrastrukturës së cilësisë;

iv. mbështetjes të zhvillimit të biznesit shqiptar brenda dhe jashtë vendit.

f) promovon transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për përmirësimin e shërbimeve dhe të procedurave publike, si dhe mbështet sipërmarrjen e biznesin në mbrojtjen e të drejtave ligjore të lidhura me aktivitetet sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike;

g) bashkërendon punën me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera shtetërore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe produktivitetin e bizneseve, si dhe mbështet sipërmarrjet në masat e nevojshme për integrimin në tregun e përbashkët evropian;

gj) promovon zhvillimin e politikave në favor të sipërmarrjes dhe biznesit, në përputhje me politikën evropiane në bashkëpunim me dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe shoqërinë civile;

h) bashkërendon instrumentet qeveritare për krijimin e një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen dhe biznesin, me qëllim nxitjen e biznesit dhe liberalizimin e tregut, nëpërmjet identifikimit të pengesave në sektorët e ekonomisë dhe formulimit të strategjive të ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative dhe kostove të biznesit;

i) promovon shmangien e praktikave të mundshme burokratike dhe arbitrare të institucioneve publike në klimën e biznesit;

j) bashkërendon punën për harmonizimin e legjislacionit në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe procedurave në zbatim të plotë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

k) ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes dhe të biznesit me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre, duke u mbështetur në partneritetin e vazhdueshëm publik privat;

l) inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe të komunikimit ndërmjet institucioneve publike dhe sipërmarrjeve, si dhe organizatave përfaqësuese të tyre;



ll) bashkërendon proceset për hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e sipërmarrjeve e të biznesit.

m) angazhohet në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen dhe klimën e biznesit;

n) propozon mekanizma institucionale dhe ndërinstitutionale, në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen dhe klimën e biznesit;

nj) inkurajon përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë;

o) përmbush çështje të tjera me ndikim në zhvillimin e sipërmarrjes dhe klimën e biznesit.

5. Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka një rol të përgjithshëm këshillues dhe koordinues në interes të politikave qeveritare për efektshmërinë, performancën e lartë dhe mirëqeverisjen në të gjithë sektorin publik dhe institucionet qeveritare, në kuadër të zhvillimit të sipërmarrjes dhe klimës së biznesit.

6. Vendimi nr. 610, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 562, datë 4.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 900,
DATË 6.12.2012, NR. 543, DATË 29.9.2021,
NR. 50, DATË 26.1.2022, NR. 522, DATË
29.7.2022, NR. 861, DATË 27.12.2022, PËR
KOMPENSIMIN FINANCIAR TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA
NDËRTIMET E LEGALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për

trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, si dhe në vijim të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 900, datë 6.12.2012, nr. 543, datë 29.9.2021, nr. 50, datë 26.1.2022, nr. 522, datë 29.7.2022, nr. 861, datë 27.12.2022, për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në vendimin nr. 900, datë 6.12.2012, të Këshillit të Ministrave në zonën kadastrale 8591, Shkodër, bazuar në gjendjen juridike aktuale, saktësohen emrat e bashkëpronarëve dhe numri i pasurisë 4/1074 që kompensohet, sipas lidhjes A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr. 543, datë 29.9.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme, sipas lidhjes B, që i bashkëlidhet këtij vendimi:

a) në zonën kadastrale 8571, në Lushnjë, për pasuritë nr. 24/294, nr. 24/296 dhe nr. 24/292 saktësohet emri i njërit prej bashkëpronarëve, si edhe saktësohen numrat e pasurive, bazuar në gjendjen juridike aktuale;

b) në zonën kadastrale 8190, në Tiranë, saktësohet numri i pasurisë 13/934, si edhe vendoset kufizimi për një nga bashkëpronarët, bazuar në gjendjen juridike aktuale.

3. Në vendimin nr. 50, datë 26.1.2022, të Këshillit të Ministrave në zonën kadastrale 8320, Tiranë, saktësohet numri i pasurisë dhe sipërfaqja për kompensim, bazuar në gjendjen juridike aktuale, sipas lidhjes C, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në vendimin nr. 522, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme, sipas lidhjes D, që i bashkëlidhet këtij vendimi:

a) në zonën kadastrale 1527, Elbasan, saktësohen numri i pasurisë dhe gjenealogjet e pronarit që kompensohet, si dhe saktësohen emrat e bashkëpronarëve, bazuar në gjendjen juridike aktuale;



b) në zonën kadastrale 2066, qarku i Tiranës, anulohet kompensimi, pasi është miratuar më parë me një vendim tjetër.

5. Në vendimin nr. 861, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme, sipas lidhjes E, që i bashkëlidhet këtij vendimi:

a) në zonën kadastrale 3321, qarku i Tiranës, saktësohet numri i pasurisë që kompensohet, bazuar në gjendjen juridike aktuale;

b) në zonën kadastrale 8110, qarku i Tiranës, saktësohet numri i pasurisë dhe pronari që kompensohet, bazuar në gjendjen juridike aktuale;

c) në zonën kadastrale 8190, qarku i Tiranës, saktësohet pronari që duhet të kompensohet, bazuar në gjendjen juridike aktuale dhe përditësimin e hartave.

II. Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Ishte / Bëhet	Të dhënat e pasurisë së legalizuar						Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Kompensimi i pronarëve								
	Nr. rendor	Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit					Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (lek/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i veçantë
					Numër	Datë												
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
Lidhja A																		
VKM nr. 900, datë 6.12.2012																		
DREJTORIA VENDORE ASHK SHKODËR, ZONA KADASTRALE 8591																		
Ishte		Xhevahir	Bilal	Hasa	3299	19.7.2010	Shtet dhe e të tretëve	38	148	Ramiz		Podgorica		4/656	38.0	8,500	323,000	
										Hysejn		Podgorica						
										Saime		Podgorica						
										Zyhdi		Podgorica						
										Nezihat		Podgorica						
										Astrit		Podgorica						
										Lulzime		Podgorica						
										Rudina		Podgorica						
Bëhet		Xhevahir	Bilal	Hasa	3299	19.7.2010	Shtet dhe e të tretëve	38	148	Agime	Ramiz	Bushati		4/1074	38.0	8,500	323,000	
										Agron	Ramiz	Podgorica						
										Nedrete	Ramiz	Osmanagiq						
										Astrit	Fadil	Podgorica						
										Lulzime	Fadil	Podgorica						
										Rudina	Fadil	Podgorica						
										Saime	Nuto	Bilali						
										Hysen	Nuto	Podgorica						
										Fatbardha	Halit	Podgorica						
										Mimoza	Zyhdi	Baraku						
										Mirjam	Zyhdi	Dizdari						
										Mentor	Zyhdi	Podgorica						
										Fatime	Abdullah	Shkupi						
										Zife	Abdullah	Dizdari						
										Zyhra	Abdullah	Gjyrezi						
										Ali	Abdullah	Podgorica						
										Muhamet	Abdullah	Podgorica						
Lidhja B																		
VKM nr. 543, datë 29.9.2021																		
DREJTORIA VENDORE ASHK LUSHNJË, BASHKIA LUSHNJË, ZONA KADASTRALE 8571																		
Ishte	323	Rrape	Riza	Musaku	112103	30.12.2019	E të tretëve		357	Rihajete	Dervish	Omari		351	24/294	357.0	9,709.0	3,466,113.0
										Jolanda	Dervish	Terpenis						
										Safete	Dervish	Vokshi						
										Skender	Dervish	Vokopola						
										Nahile	Dervish	Vokopola						
										Rihajete	Dervish	Omari						
										Jolanda	Dervish	Terpenis						
										Safete	Dervish	Vokshi						
										Skender	Dervish	Vokopola						
	324	Ncim	Ali	Dervishi	77860	11.6.2013	E të tretëve		474	Rihajete	Dervish	Terpenis		352	24/294	474.0	9,709.0	4,602,066.0
										Jolanda	Dervish	Terpenis						
										Safete	Dervish	Vokshi						
										Skender	Dervish	Vokopola						



	325	Selman	Ali	Dervishi	895	21.6.2018	Shtet dhe e të tretëve	500	Nabile	Dervish	Vokopola	353	24/296	348.6	9,709.0	3,384,557.4	
									Rihajete	Dervish	Omari						
									Jolanda	Dervish	Terpenis						
									Safete	Dervish	Vokshi						
									Skender	Dervish	Vokopola	354	24/292	59.3	9,709.0	575,743.7	
									Nabile	Dervish	Vokopola						
Bëhet		Rrape	Riza	Musaku	112103	30.12.2019	E Të Tretëve	357	Rihajete	Dervish	Omari						
									Jolanda	Dervish	Terpenis	351	24/343	357.0	9,709.0	3,466,113.0	
									Safete	Dervish	Vokshi						
									Skender	Dervish	Vokopola						
									Hakik	Dervish	Vokopola						
		Neim	Ali	Dervishi	77860	11.6.2013	E Të Tretëve	474	Rihajete	Dervish	Omari						
									Jolanda	Dervish	Terpenis						
									Safete	Dervish	Vokshi	352	24/344	474.0	9,709.0	4,602,066.0	
									Skender	Dervish	Vokopola						
									Hakik	Dervish	Vokopola						
		Selman	Ali	Dervishi	895	21.6.2018	Shtet Dhe E Të Tretëve	500	Rihajete	Dervish	Omari	353	24/331	348.6	9,709.0	3,384,557.4	
									Jolanda	Dervish	Terpenis						
									Safete	Dervish	Vokshi						
									Skender	Dervish	Vokopola	354	24/333	59.3	9,709.0	575,743.7	
									Hakik	Dervish	Vokopola						

VKM NR. 543, datë 29.9.2021

DREJTORIA VENDORE ASHK TIRANE JUG, ZONA KADASTRALE 8190

Ishte	1	Shkelqim	Enver	Haxhiu	77460	12.6.2015	Të tretëve		MBIVENDOSJE			13/802	141.9	33,755.0	4,789,834.5	Titulli i kësaj pronësie përfshin edhe pasuritë 13/782, 13/785, 13/786, 13/787, 13/788, 13/789, 13/790, 13/791, 13/792, 13/793, 13/796, 13/797, 13/794, 13/802, 13/784, 13/795, 13/808, 13/803, 13/804, 13/805, 13/798, të kufizuara për efekt të mbivendosjes.
									Alda	Toptani						
									Ardian	Toptani						
									Fadil	Toptani						
									Lumturi	Toptani						
									Mynevere	Toptani						
									Vera	Toptani						
Bëhet	1	Shkelqim	Enver	Haxhiu	77460	12.6.2015	Të tretëve		MBIVENDOSJE			13/968	142.0	33,755.0	4,793,210.0	Ref. 00011097, datë 19.1.2021, vendoset masë sig. padie të mos kryhet asnjë veprim me pasurinë v. Gjyk. nr. 985 datë 17.12.2020, urdhër sek. kons. nr. 6816 prot., datë 31.12.2020, ASHK nr. 159, prot. datë 11.1.2021
									Alda	Toptani		13/934	358.0	33,755.0	12,084,290.0	
									Ardian	Toptani						
									Fadil	Toptani						



Ishte	1359	Gezim	Idriz	Kulli	124	24.2.2021	Pronar		310.2	Hekuran	Ibrahim	Kulli		50/4	310.2	260	80,652	
Bëhet	1359	Gezim	Idriz	Kulli	124	24.2.2021	Pronar		310.2	Idriz	Hamit	Kulli		49/12	310.2	260	80,652	

VKM nr. 522, datë 29.7.2022

DREJTORIA VENDORE ASHK KAMËZ-VORE, ZONA KADASTRALE 2066

Ishte	73	Ilber	Xhemal	Gjoka	70208318	21.4.2017	Të tretëve (208.8 m²)		208.8	Rajmonda	Naim	Gjoni		86	200/91	208.8	472	98,553.6	
										Fjoralba	Naim	Gjoni							
										Feride	Zyber	Arriku							
Bëhet		ANULOHE								ANULOHE									

Lidhja E

VKM NR. 861, datë 27.12.2022

DREJTORIA VENDORE ASHK TIRANA RURALE 1, ZONA KADASTRALE 3321

Ishte		NASIBE	ISTREF	MEMA	130839	16.5.2018	T. vet + të tretëve			Shkelqim	Ramadan	Belba		4/36	69.2	2,560	177,152	
Bëhet		NASIBE	ISTREF	MEMA	130839	16.5.2018	T. vet + të tretëve			Shkelqim	Ramadan	Belba		4/8/1	69.2	2,560	177,152	

VKM nr. 861, datë 27.12.2022

QARKU TIRANË, ASHK TIRANA VERI, ZONA KADASTRALE 8110

Ishte		Shpendi	Skender	Allushi	150	10.2.2021	Të tretëve+ shtet		550.82	Abdulla	Hamit	Myftiu						
										Aferdita	Ramazan	Basha						
										Agim		Basha						
										Ahmet	Hamit	Myftiu						
										Ahmet	Ramazan	Basha						
										Emine	Rexhep	Basha						
										Eqerem	Hajdar	Basha						
										Fitnete	Shaqir	Basha						
										Gjyle	Sefer	Basha		3/148	242.3	23,703	5,743,236.90	
										Hatixhe	Hamit	Kruetani						
										Ismete	Hamit	Myterizi						
										Luan	Ramazan	Basha						
										Lulzim	Ramazan	Basha						
										Muhamet	Hajdar	Basha						
										Nale	Ramazan	Basha						
										Qemal	H	Basha						
										Sadik	Hamit	Myftiu						

[illegible]

**VENDIM****Nr. 563, datë 4.10.2023****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 87, DATË 14.2.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT
TË SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË
SHQIPËRI DHE IDENTIFIKIMIN E
PROJEKTEVE PRIORITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 4, të nenit 5, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në dokumentin “Instrumenti lehtësues për projektet e infrastrukturës (IPF), asistencë teknike 4 (IPF 4) – WB11-ALB-ENE-01, Masterplani i Infrastrukturës së Gazit, raporti përfundimtar”, bashkëlidhur vendimit nr. 87, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3.2, me titull “Konteksti brenda sektorit të gazit dhe strategjitë përkatëse”, paragrafi i pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shoqëria TAP AG do të ndërtojë dhe do të operojë gazsjellësin TAP. Shqipëria, Greqia dhe Italia kanë nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare për TAP-in. Në bazë të vendimit të përbashkët të enteve rregullatore të energjisë të Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë, më qershor 2013, TAP AG është e detyruar të ndërtojë të paktën një pikë daljeje me dy drejtime (bidireksionale) në Shqipëri (që gjendet në Fier), me një kapacitet prej 2–10 mmk/ditë (0,73–3,65 bmk/vit). Përveç Fierit, një pikë e dytë daljeje është në diskutim në zonën e Kuçovës.”.

2. Në pikën 5.6, nënndarja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Presioni maksimal i lejuar:

- 82 bar, për seksionet e IAP dhe deri në 100 bar për pjesën tjetër të sistemit të transmetimit në Shqipëri;

- Deri në 100 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston.”.

3. Në pikën 9 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në listën e prioritetëve në terma afatshkurtër shtohet nënndarja 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Zhvillimi i pikës së daljes dhe rrjetit të shpërndarjes Bashkia Korçë”.

b) Në listën e prioritetëve në terma afatmesëm shtohet nënndarja 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministritë e institucionet përgjegjëse, të përmendura në planin e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 564, datë 4.10.2023****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I
GODINAVE TË SPITALIT ‘SHENJTA
MARI’ DHE DREJTORIA E SHËNDETIT
PUBLIK (ISH-SPITALI INFEKTIV),
NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i godinave të spitalit ‘Shenja Mari’ dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), njësia administrative Rreshen”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Mirditë.



3. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 890 257 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 890 257 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Mirditë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Mirditë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mirditë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mirditë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mirditë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Mirditë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mirditë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘RIKONSTRUKSIONI I GODINAVE TË SPITALIT ‘SHENJTA MARI’ DHE DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK (ISH- SPITALI INFEKTIV), NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE															Adresa	Shënime (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Arë (m²)	Tfuall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Tfuall			Ndërtesë				Vlera totale (lek)
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Vlera e preventivit (lek)			
1	Mrikë Gjon Përgega			Rrëshen	3224	3/35	Godinë	54	-	54	54	6	127	54	2,351	126,954	54	763,303.0	890,257.00	Rrëshen	Nuk ka

**VENDIM****Nr. 565, datë 4.10.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE PERONDI,
FSHATI TAPI, KUÇOVË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike të njësisë administrative Perondi, fshati Tapi, Kuçovë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 673 696 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 673 696 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga Bashkia Kuçovë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Kuçovë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Kuçovë.

8. Bashkia Kuçovë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kuçovë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Kuçovë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Kuçovë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kuçovë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE PERONDI, FSHATI TAPI, KUÇOVË”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
												ARË			Vlerat e kulturave bujqësore dhe drufrutore sipas proces- verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTAL E (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose dyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Vlera e kulturave bujqësore (lek)	Vlera e drufrutorëve (lek)		
1	Bekdash	Yzeir	Troka	Tapi	3561	1280/55	Arë	560	560	4	21	560	311	174 160		120 000	294 160	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Behar	Yzeir	Troka	Tapi	3561	1280/53	Arë	472	472	4	19	472	311	146 792			146 792	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Nebi	Yzeir	Troka	Tapi	3561	1280/56	Arë	560	560	4	22	560	311	174 160		58584	232 744	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Nazire	Jonus	Troka	Tapi														
																	673 696	

VENDIM Nr. 566, datë 4.10.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË FSHATIT XHAFZOTAJ”, BASHKIA SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi territorial i varrezave të fshatit Xhafzotaj”, Bashkia Shijak.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shijak.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 847 500 (tetëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 847 500 (tetëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekësh, përballohet nga Bashkia Shijak.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Shijak.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Shijak.

8. Bashkia Shijak kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shijak.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Shijak, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shijak për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së



gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shijak për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shijak, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Shijak, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe

e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË FSHATIT XHAFZOTAJ”, BASHKIA SHIJAK

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)								TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM			SHËNIME	
												Arë				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Arë (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)		VLERA TOTALE (lek)
1	Gani	Hasan	Nderjaku	Xhafzotaj	3852	110/48	Arë	2500	2500	0	0	2500	339	847,500	847,500	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE															847,500	

VENDIM
Nr. 567, datë 4.10.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 300, DATË 11.5.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT ‘SISTEMIM RRUGËSH, BLOKU TE STADIUMI, POGRADec”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 300, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, numri i pasurisë 1/338, ZK 8581, në numrin rendor 1 të tabelës, zëvendësohet me numrin e pasurisë 1/388.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Pogradec.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Pogradec, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM**

Nr. 568, datë 4.10.2023

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT, SI AUTORITET
KONTRAKTOR PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT TË ZONËS
MULTIFUNKSIONALE PËRRETH
KOMPLEKSIT TË STADIUMIT
“SKËNDERBEU” NË KORÇË,
PËRFSHIRË STADIUMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për zbatimin e projektit për zhvillimin e zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit “Skënderbeu” në Korçë, përfshirë stadiumin.

2. Në funksion të zbatimit të projektit, të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre dhe të projektit përkatës, duke përdorur fonde nga programet aktuale të zhvillimit;

b) paraqitjen e kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit pranë autoritetit kompetent të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e të procedurave të nevojshme për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e territorit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Korçë lidhin marrëveshje bashkëpunimi në funksion të zhvillimit të projektit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Korçë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

URDHËR

Nr. 119, datë 29.9.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI
KUADRIN RREGULLATOR PËR
HAPËSIRËN – U TË HAPËSIRËS
AJRORE”¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 7, pika 2, nenin 50, pika 3 dhe nenin 84, pika 6, të ligjit nr. 96/2020, datë 23.8.2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 43 dhe 44, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e Aviacionit Civil” dhe ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kuadrin rregullator për hapësirën – U të hapësirës ajrore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

¹Ky urdhër përafron rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2021/664, të datës 22 prill 2021, mbi kuadrin rregullator për hapësirën – U, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 139, 23.4.2021 e ndryshuar me rregulloren e Komisionit nr. 2023/203 e datës 27 tetor 2022, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 31, 2.2.2023.

**RREGULLORE****MBI KUADRIN RREGULLATOR PËR
HAPËSIRËN – U TË HAPËSIRËS AJRORE****KAPITULLI I
PARIMET DHE KËRKESAT E
PËRGJITHSHME****Neni 1****Lënda dhe qëllimi**

1. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për operimet e sigurta të Sistemeve të Avionëve pa Pilot (UAS) në hapësirën U të hapësirës ajrore për integrimin e sigurt të UAS-së në sistemin e aviacionit dhe për ofrimin e shërbimeve të hapësirës U.

2. Kjo rregullore do të zbatohet brenda zonave gjeografike të UAS-së, të krijuara si hapësira U e hapësirës ajrore, nëpërmjet Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare, për:

- a) operatorët e UAS-së-së;
- b) ofruesit e shërbimeve të hapësirës U;
- c) ofruesit e shërbimit të informacionit.

3. Kjo rregullore nuk do të zbatohet për operimet e UAS-së-së të kryera:

a) në kuadër të klubeve dhe shoqatave aeronautike që kanë marrë një autorizim në përputhje me nenin 16 të urdhrit të ministrit nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot”;

b) në nënkategorinë A1 të kategorisë ‘open’ për operimet e avionëve pa pilot, të cilët:

i) në rastin e një UAS të ndërtuar privatisht, ka një masë maksimale ngritjeje, duke përfshirë ngarkesën, më pak se 250 g dhe një shpejtësi maksimale operimi më pak se 19 m/s; ose

ii) është shënuar si klasa C0 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 1 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot”; ose

c) në përputhje me SERA.5015 “Rregullat e fluturimit me instrument”, të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat

operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”.

Neni 2**Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror’”, urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”, urdhrin e ministrit nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot”, urdhrin e ministrit nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot”, si dhe përkufizimet e mëposhtme:

1) “Hapësira U e hapësirës ajrore” nënkupton një zonë gjeografike të sistemeve të avionëve pa pilot (UAS), e përcaktuar nëpërmjet Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare, ku operimet UAS lejohen të kryhen vetëm me mbështetjen e shërbimeve U-space;

2) “Rikonfigurim dinamik i hapësirës ajrore” nënkupton modifikimin e përkohshëm të hapësirës U të hapësirës ajrore për të akomoduar ndryshimet afatshkurtra në kërkesën e trafikut të drejtuar me pilot, duke rregulluar kufijtë gjeografikë të asaj hapësire U të hapësirës ajrore.

3) “Shërbimi i hapësirës U” nënkupton një shërbim që mbështetet në shërbimet digjitale dhe automatizimin e funksioneve të krijuara për të mbështetur akses të sigurt operimi dhe ndaj ndërhyrjeve të paligjshme dhe efikas në hapësirën U të hapësirës ajrore, për një numër të madh UAS;

4) “Shërbimi i informacionit të përbashkët” është një shërbim që konsiston në shpërndarjen e të dhënave statike dhe dinamike për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të hapësirës U për menaxhimin e trafikut të avionëve pa pilot;

5) “Vendi kryesor i biznesit” nënkupton zyrën qendrore ose zyrën e regjistruar të një ofruesi të shërbimeve të hapësirës U ose ofruesi i shërbimit të



informacionit të përbashkët në Republikën e Shqipërisë, kur Shqipëria është vendi brenda të cilit ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operacional i ofruesit të shërbimit;

6) “Vlerësimi i riskut të hapësirës ajrore” nënkupton një vlerësim i risqeve operationale, të sigurisë në operim dhe të sigurisë në aviacion, që merr parasysh nivelet e kërkuara të performancës së sigurisë në operim siç përcaktohet në Planin Evropian për Sigurinë e Aviacionit dhe Programin Shtetëror të Sigurisë të përmendur në nenet 6 dhe 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, llojin, kompleksitetin dhe dendësinë e trafikut, vendndodhjen, lartësinë ose lartësitë dhe klasifikimin e hapësirës ajrore;

KAPITULLI II HAPËSIRA U E HAPËSIRËS AJRORE DHE SHËRBIMI I INFORMACIONIT TË PËRBASHKËT

Neni 3

Hapësira U e hapësirës ajrore

1. Kur nëpërmjet Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore, përcaktohet hapësira U e hapësirës ajrore, për arsye të sigurisë në operim, sigurisë në aviacion, privatësisë ose të mjedisit, ky përcaktim do të mbështetet nga një vlerësim i riskut të hapësirës ajrore.

2. Të gjitha operimet UAS në hapësirën U të hapësirës ajrore janë subjekt, të paktën, i shërbimeve të detyrueshme të hapësirës U, të mëposhtme;

a) shërbimin e identifikimit të rrjetit të përmendur në nenin 8;

b) shërbimin e gjeondërgjegjësisë të përmendur në nenin 9;

c) shërbimi i autorizimit të fluturimit UAS i përmendur në nenin 10;

d) shërbimin e informacionit mbi trafikun e përmendur në nenin 11.

3. Për çdo hapësirë U të hapësirës ajrore, bazuar në vlerësimin e riskut të hapësirës ajrore të përmendur në paragrafin 1, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kërkojë shërbime shtesë të hapësirës U të zgjedhura nga shërbimet e përmendura në nenet 12 dhe 13.

4. Për çdo hapësirë U të hapësirës ajrore, bazuar në vlerësimin e riskut të hapësirës ajrore të

përmendur në paragrafin 1 dhe duke përdorur kriteret e përcaktuara në aneksin I, Autoriteti i Aviacionit Civil do të përcaktojë:

a) kapacitetet e UAS-së dhe kërkesat e performancës;

b) kërkesat e performancës së shërbimeve të hapësirës U;

c) kushtet operationale të zbatueshme dhe kufizimet e hapësirës ajrore.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil do t’u japë akses ofruesve të shërbimeve të hapësirës U në të dhënat përkatëse, nëse kërkohet për zbatimin e kësaj rregulloreje, në lidhje me:

a) sistemin e regjistrimit të operatorëve UAS, përmendur në nenin 14 të urdhrit të ministrit nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, të Republikës së Shqipërisë, në të cilin ofruesit e shërbimeve të hapësirës U ofrojnë shërbimet e tyre;

b) kur të jetë e zbatueshme, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, sistemet e regjistrimit të operatorëve të UAS-së të Shteteve të tjera Anëtare përmes bazave të informacionit të përmendur në nenin 74 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

6. Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion informacionin mbi hapësirën U të hapësirës ajrore në përputhje me nenin 15(3) të urdhrit të ministrit nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, si dhe nëpërmjet shërbimit të informacionit aeronautik të saj.

7. Kur vendoset të krijohet një hapësirë ndërkufitare U e hapësirës ajrore bashkërisht mes shteteve kufitare vendoset për:

a) përcaktimin e hapësirës ndërkufitare U ajrore të hapësirës ajrore;

b) ofrimin e shërbimeve ndërkufitare të hapësirës U;

c) ofrimin e shërbimeve ndërkufitare të informacionit të përbashkët.

Neni 4

Rikonfigurimi dinamik i hapësirës ajrore

1. Kur caktohet një hapësirë U brenda hapësirës ajrore të kontrolluar duhet të sigurohet që rikonfigurimi dinamik i hapësirës ajrore brenda asaj



hapësire U të hapësirës ajrore, do të zbatohet siç përcaktohet në ATS.TR.237 të urdhrin të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre””, apo çdo ndryshim të tij për t’u siguruar që avionët me pilot, të cilët ofrohen me shërbim të kontrollit të trafikut ajror dhe UAS të mbeten të veçuar.

2. Parashikimi i pikës 1, i këtij neni, do të zbatohet jo më vonë se dy vite nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Shërbimi i Informacionit të Përbashkët

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të dhënat e mëposhtme si pjesë e shërbimeve të informacionit të përbashkët të çdo hapësire U të hapësirës ajrore:

a) kufijtë horizontalë dhe vertikal të hapësirës U të hapësirës ajrore;

b) kërkesat e përcaktuara në përputhje me nenin 3(4);

c) një listë të ofruesve të certifikuar për shërbimet e hapësirës U që ofrojnë shërbime të hapësirës U në hapësirën ajrore, me informacionin e mëposhtëm:

i. identifikimin dhe detajet e kontaktit të ofruesve aktivë të shërbimit të hapësirës U;

ii. shërbimet e hapësirës U të ofruara;

iii. kufizimet në certifikatën e lëshuar, nëse ka.

d) çdo hapësirë U të hapësirës ajrore fqinje;

e) zonat gjeografike të UAS-së përkatëse për hapësirën U të hapësirës ajrore dhe të publikuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”;

f) kufizimet statike dhe dinamike të hapësirës ajrore të përcaktuara nga autoritetet përkatëse dhe kufizimin e përhershëm ose të përkohshëm të vëllimit të hapësirës ajrore brenda hapësirës U të hapësirës ajrore ku mund të zhvillohen operimet UAS.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurohet që të dhënat operationale përkatëse të referuara në ATS.OR.127 të urdhrin të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022, “Për miratimin

e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”, si dhe të dhënat që rezultojnë nga rikonfigurimi dinamik i hapësirës ajrore të përmendur në ATS.TR.237 të saj, vihen në dispozicion si pjesë e shërbimeve të informacionit të përbashkët të çdo hapësire U të hapësirës ajrore.

3. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U do të vënë në dispozicion termat dhe kushtet e shërbimeve të tyre si pjesë e shërbimeve të informacionit të përbashkët të çdo hapësire U të hapësirës ajrore në të cilën ata ofrojnë shërbimet e tyre.

4. Ofruesit e shërbimeve të informacionit të përbashkët do të sigurojnë që informacioni i përmendur në paragrafët 1, 2 dhe 3:

a) vihet në dispozicion në përputhje me aneksin II;

b) përputhet me kërkesat e nevojshme për cilësinë, vonesën dhe mbrojtjen e të dhënave të përcaktuara në aneksin III.

5. Aksesit në shërbimet e informacionit të përbashkët do t’u jepet autoriteteve përkatëse, ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror, ofruesve të shërbimeve të hapësirës U dhe operatorëve UAS mbi baza jodiskriminuese, duke përfshirë të njëjtat nivele të cilësisë së të dhënave, vonesës dhe mbrojtjes.

6. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të caktojë një ofrues të vetëm të përbashkët të shërbimit të informacionit për të ofruar shërbimet të informacionit të përbashkët në baza ekskluzive në të gjitha ose disa nga hapësirat U të hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e Shqipërisë. Në këtë rast, informacioni i përmendur në paragrafët 1 deri në 3 do t’i vihet në dispozicion ofruesit të vetëm të shërbimit të informacionit të përbashkët, i cili më pas do ta japë atë në përputhje me paragrafin 5.

7. Një ofrues i tillë i vetëm i përbashkët i shërbimit të informacionit duhet të përmbushë kërkesat e përmendura në paragrafët 4 dhe 5 dhe do të certifikohet në përputhje me kapitullin V të kësaj rregulloreje.

8. Nëse Autoriteti i Aviacionit Civil cakton një ofrues të vetëm të shërbimit të informacionit të përbashkët, kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, ai do të informojë Agjencinë dhe shtetet e tjera anëtare pa vonesë për çdo vendim në lidhje me certifikatën e ofruesit të vetëm të shërbimit të informacionit të



përbashkët. Agjencia do të përfshijë në bazën e përmendur në nenin 74 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, informacion në lidhje me të gjitha vendimet e njoftuara nga shtetet anëtare në bazë të këtij paragrafi.

KAPITULLI III KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR OPERATORËT E UAS-së DHE OFRUESIT E SHËRBIMIT TË HAPËSIRËS U

Neni 6 Operatorët UAS

1. Kur operojnë në hapësirën U të hapësirës ajrore operatorët UAS, duhet:

a) të sigurojnë që UAS që do të operohet në hapësirën U të hapësirës ajrore të jetë në përputhje me kapacitetet dhe kërkesat e performancës të përcaktuara në përputhje me nenin 3(4)(a);

b) të sigurojnë që gjatë operimeve të tyre, të përdoren shërbimet e nevojshme të hapësirës U, të përmendura në nenin 3, pikat 2 dhe 3, dhe të përmbushen kërkesat e tyre;

c) përputhen me kushtet e zbatueshme operationale dhe kufizimet e hapësirës ajrore të përmendura në nenin 3(4)(c).

2. Operatorët UAS mund të ofrojnë vetë shërbime të hapësirës U. Në një rast të tillë, ata do të konsiderohen si ofrues të shërbimit të hapësirës U për qëllimet e kësaj rregulloreje.

3. Përpara se të operojnë në hapësirën U të hapësirës ajrore, operatorët e UAS-së duhet të përmbushin kërkesat e urdhrit të ministrit nr. 143, datë 18.7.2022, “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, një autorizim operacional ose një certifikatë të lëshuar nga AAC-ja, si autoriteti kompetent kur Shqipëria është vendi i regjistrimit dhe në përputhje me kufizimet operationale të vendosura nga Autoriteti i Aviacionit Civil në çdo zonë gjeografike të UAS-së.

4. Përpara çdo fluturimi individual, operatori UAS duhet t'i paraqesë një kërkesë për autorizim fluturimi UAS ofruesit të tij të shërbimit të hapësirës U, nëpërmjet shërbimit të autorizimit të fluturimit UAS të përmendur në nenin 10, në përputhje me aneksin IV.

5. Kur të jetë gati për të nisur fluturimin, operatori UAS do të kërkojë nga ofruesi i shërbimit të hapësirës U, aktivizimin e autorizimit të fluturimit UAS. Me marrjen e konfirmimit të aktivizimit për autorizimin e fluturimit UAS nga ofruesi i shërbimit të hapësirës U, operatori UAS ka të drejtë të fillojë fluturimin e tij.

6. Operatorët e UAS-së duhet të operojnë në përputhje me autorizimin e fluturimit UAS, duke përfshirë pragjet (thresholds) e devijimit të autorizimit të përmendura në nenin 10(2)(d), si dhe me çdo ndryshim të tij. Ofruesi i shërbimit të hapësirës U mund të prezantojë ndryshime në autorizim gjatë çdo faze të fluturimit dhe, në këtë rast, do të informojë operatorët UAS për to.

7. Kur operatorët e UAS-së nuk janë në gjendje të respektojnë pragjet e devijimit të autorizimit të fluturimit UAS të përmendura në nenin 10(2)(d), ata do të kërkojnë një autorizim të ri fluturimi UAS.

8. Operatorët e UAS-së do të sigurojnë masa dhe procedura kontigjence. Ata do t'i vënë masat dhe procedurat e tyre të kontigjencës në dispozicion të ofruesve të shërbimit të hapësirës U.

Neni 7 Ofruesit e shërbimit të hapësirës U

1. Shërbimet e hapësirës U do të ofrohen nga persona juridikë të certifikuar si ofrues të shërbimeve të hapësirës U në përputhje me kapitullin V.

2. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U do të jenë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të hapësirës U, operatorëve UAS të përmendur në nenin 3, pikat 2 dhe 3, gjatë të gjitha fazave të operimeve, në atë hapësirë U të hapësirës ajrore.

3. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U do të vendosin marrëveshje me ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror për të siguruar koordinimin e duhur të aktiviteteve, si dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve përkatëse operationale në përputhje me aneksin V.

4. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U do të trajtojnë të dhënat e trafikut ajror pa diskriminim, kufizim ose ndërhyrje, pavarësisht nga dërguesi ose marrësi i tyre, përmbajtja, aplikacioni ose shërbimi ose pajisjet terminale.

5. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U:

a) do të shkëmbejnë çdo informacion që është i rëndësishëm për ofrimin e sigurt të shërbimeve hapësirës U ndërmjet tyre;



b) do t'i përmbahen një protokollit të përbashkët të sigurt të komunikimit të hapur dhe do të përdorin informacionin më të fundit të vënë në dispozicion në përputhje me aneksin II;

c) do të sigurojnë që informacioni të shkëmbehet në përputhje me kërkesat e cilësisë, vonësës dhe mbrojtjes së të dhënave të përcaktuara në aneksin III;

d) do të sigurojnë aksesin dhe mbrojtjen e nevojshme të informacionit të shkëmbyer.

6. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U duhet t'i raportojnë AAC-së, si autoriteti kompetent për sa vijon:

a) fillimin e operimeve pas marrjes së certifikatës së përmendur në nenin 14;

b) ndërprerjen dhe rifillimin e mëposhtëm të operimeve, nëse është e aplikueshme.

KAPITULLI IV SHËRBIMET E HAPËSIRËS U

Neni 8 Shërbimi i identifikimit të rrjetit

1. Një shërbim i identifikimit të rrjetit do të lejojë procesin e vazhdueshëm të identifikimit në distancë të UAS-së gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit dhe do të sigurojë identifikimin në distancë të UAS-së për përdoruesit e autorizuar të përmendur në paragrafin 4 në mënyrë të përmblodhur.

2. Shërbimi i identifikimit të rrjetit do t'u lejojë përdoruesve të autorizuar të marrin mesazhe me përmbajtjen e mëposhtme:

a) numrin e regjistrimit të operatorit UAS;

b) numrin serial unik të avionit pa pilot ose, nëse avioni pa pilot është i ndërtuar privatisht, numrin serial unik të shtesës;

c) pozicionin gjeografik të UAS, lartësinë mbi nivelin mesatar të detit dhe lartësinë mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

d) kursin e rrugës të matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësinë në tokë të UAS;

e) pozicionin gjeografik të pilotit remote ose, nëse nuk disponohet, pikën e ngritjes;

f) statusin e emergjencës së UAS;

g) kohën në të cilën u krijuan mesazhet.

3. Informacioni i ofruar nga shërbimet e identifikimit të rrjetit do të përditësohet me një frekuencë që ka përcaktuar Autoriteti i Aviacionit Civil.

4. Përdoruesit e autorizuar, do të jenë:

a) publiku i gjerë në lidhje me informacionin që konsiderohet publik në përputhje me rregullat e aplikueshme kombëtare;

b) ofruesit e tjerë të shërbimeve të hapësirës U për të garantuar sigurinë e operimeve në hapësirën U të hapësirës ajrore;

c) ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror që kanë interes;

d) kur përcaktohet, ofruesi i vetëm i përbashkët i shërbimit të informacionit;

e) autoritetet kompetente përkatëse.

Neni 9 Shërbimi i gjeondërgjegjësisimit

1. Një shërbim i gjeondërgjegjësisimit i përbërë nga informacioni i mëposhtëm i gjeondërgjegjësisimit, do t'u ofrohet operatorëve të UAS-së:

a) informacion mbi kushtet e zbatueshme operacionale dhe kufizimet e hapësirës ajrore brenda hapësirës U të hapësirës ajrore;

b) zonat gjeografike të UAS-së, përkatëse për hapësirën U të hapësirës ajrore;

c) kufizime të përkohshme të zbatueshme për përdorimin e hapësirës ajrore brenda hapësirës U të hapësirës ajrore.

2. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U të hapësirës ajrore do të dërgojnë informacionin e gjeondërgjegjësisimit në kohën e duhur për të lejuar adresimin e rasteve dhe emergjencave nga operatorët UAS dhe do të përfshijnë kohën e përditësuar së bashku me një numër versioni, një kohë të vlefshme, ose të dyja.

Neni 10 Shërbimi i autorizimit të fluturimit UAS

1. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U do t'u ofrojnë operatorëve UAS autorizimin e fluturimit UAS për çdo fluturim individual, duke vendosur termat dhe kushtet e atij fluturimi, nëpërmjet një shërbimi të autorizimit të fluturimit UAS.

2. Kur ofruesit e shërbimit të hapësirës U marrin nga operatori UAS një kërkesë për autorizim fluturimi UAS, ata duhet:

a) të kontrollojnë nëse kërkesa për autorizimin e fluturimit UAS është e plotë dhe e saktë dhe e dorëzuar në përputhje me aneksin IV;

b) të pranojnë kërkesën për autorizimin e fluturimit UAS nëse fluturimi sipas autorizimit të



fluturimit UAS është i lirë nga kryqëzimi në hapësirë dhe kohë me çdo autorizim tjetër fluturimi të njoftuar UAS brenda të njëjtës hapësirë ajrore UAS në përputhje me rregullat e përparësisë të përcaktuara në paragrafin 8;

c) të njoftojë operatorin UAS për pranimin ose refuzimin e kërkesës për autorizimin e fluturimit UAS;

d) kur njoftojnë operatorin UAS për pranimin e kërkesës për autorizimin e fluturimit UAS, të tregojnë pragjet e lejuara të devijimit të autorizimit të fluturimit UAS.

3. Kur lëshojnë një autorizim fluturimi UAS, ofruesit e shërbimit të hapësirës U do të përdorin, aty ku është e aplikueshme, informacionin e motit të dhënë nga shërbimi i informacionit të meteorologjisë siç referohet në nenin 12.

4. Kur ofruesit e shërbimit të hapësirës U nuk janë në gjendje të japin një autorizim fluturimi UAS në përputhje me kërkesën e operatorit UAS, ofruesit e shërbimit U mund t'i propozojnë operatorit të UAS-së një autorizim alternativ fluturimi UAS.

5. Pas marrjes së kërkesës për aktivizimin e autorizimit të fluturimit UAS të përmendur në nenin 6(5), ofruesit e shërbimit të hapësirës U do të konfirmojnë aktivizimin e autorizimit të fluturimit UAS pa vonesa të pajustificuara.

6. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U do të vendosin marrëveshjet e duhura për të zgjidhur kërkesat konfliktuale për autorizimin e fluturimit UAS të marra nga operatorët UAS nga ofrues të ndryshëm të shërbimeve të hapësirës U.

7. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U do të kontrollojnë kërkesën për autorizime fluturimi UAS kundrejt kufizimeve të hapësirës U të hapësirës ajrore, si dhe kufizimeve të përkohshme të hapësirës ajrore.

8. Gjatë përpunimit të kërkesave për autorizim fluturimi UAS, ofruesit e shërbimit të hapësirës U do t'i japin përparësi UAS që kryen operacione speciale siç referohet në nenin 4 të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.3.2023, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”.

9. Kur dy kërkesa për autorizime fluturimi UAS kanë të njëjtin prioritet, ato do të përpunohen mbi bazën e parimit “kush vjen i pari shërbehet i pari”.

10. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U do të kontrollojnë vazhdimisht autorizimet ekzistuese të fluturimit kundrejt kufizimeve dhe kufizimeve të reja dinamike të hapësirës ajrore, dhe informacionin në lidhje me trafikun e avionëve të drejtuar nga njësitë përkatëse të shërbimit të trafikut ajror, veçanërisht në lidhje me avionët e drejtuar me pilot, të njohur ose që besohet se janë në gjendje emergjence, duke përfshirë, ndërhyrjet të paligjshme, dhe përditësimin ose tërheqjen e autorizimeve siç mund të jetë e nevojshme nga rrethanat.

11. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U do të lëshojnë një numër unik autorizimi për çdo autorizim fluturimi UAS. Ky numër do të mundësojë identifikimin e fluturimit të autorizuar, operatorit UAS dhe ofruesit të shërbimit të hapësirës U që lëshon autorizimin e fluturimit UAS.

Neni 11

Shërbimi informacionit të trafikut

1. Një shërbim informacioni mbi trafikun i ofruar operatorit të UAS-së do të përmblajë informacion mbi çdo trafik tjetër ajror të dukshëm, që mund të jetë afër pozicionit ose itinerarit të synuar të fluturimit UAS.

2. Shërbimi i informacionit mbi trafikun do të përfshijë informacionin për avionë me pilot dhe trafikun UAS të ndarë nga ofruesit e tjerë të shërbimit të hapësirës U dhe njësitë përkatëse të shërbimit të trafikut ajror.

3. Shërbimi i informacionit mbi trafikun do të sigurojë informacione për trafikun tjetër të njohur ajror dhe do të:

a) përfshijë pozicionin, kohën e raportimit, si dhe shpejtësinë, drejtimin ose drejtimin dhe gjendjen e emergjencës së avionit, kur dihet;

b) përditësohet me një frekuencë që e ka përcaktuar autoriteti kompetent.

4. Me marrjen e shërbimeve të informacionit të trafikut nga ofruesi i shërbimit të hapësirës U, operatorët UAS do të ndërmarrin veprimet përkatëse për të shmangur çdo rrezik përplasjeje.

Neni 12

Shërbimi i informacionit meteorologjik

1. Kur ofrojnë një shërbim informacioni për meteorologjinë, ofruesit e shërbimit U, duhet:



a) të mbledhin të dhëna të motit, të ofruara nga burime të besuara, për të ruajtur sigurinë dhe për të mbështetur vendimet operacionale të shërbimeve të tjera të hapësirës U;

b) t'i sigurojë operatorit UAS parashikimet e meteorologjisë dhe informacionin aktual të motit si para ose gjatë fluturimit.

2. Shërbimi i informacionit të meteorologjisë do të përfshijë, minimalisht:

a) drejtimin e erës të matur në drejtim të akrepave të orës përmes veriut të vërtetë dhe shpejtësinë në metra për sekondë, duke përfshirë erërat e forta;

b) lartësinë e shtresës më të ulët të thyer ose të mbuluar me re e shprehur në qindra këmbë (fët) mbi nivelin e tokës;

c) dukshmërinë në metra dhe kilometra;

d) temperaturën dhe pikën e vesës;

e) treguesit e aktivitetit konvektiv dhe precipitimi i reshjeve;

f) vendndodhjen dhe kohën e vëzhgimit, ose oraret dhe vendndodhjet e vlefshme të parashikimit;

g) QNH-ja përkatëse me vendndodhjen gjeografike të zbatueshmërisë së saj.

3. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U do të ofrojnë informacione të meteorologjisë që janë të përditësuara dhe të besueshme për të mbështetur funksionimin e UAS-së.

Neni 13

Shërbimi i monitorimit të konformitetit

1. Një shërbim i monitorimit të konformitetit do t'u mundësojë operatorëve të UAS-së të verifikojnë nëse janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 6(1) dhe kushtet e autorizimit të fluturimit UAS. Për këtë qëllim, ky shërbim do të njoftojë operatorin e UAS-së kur kufijtë e devijimit të autorizimit të fluturimit shkelen dhe kur kërkesat në nenin 6(1) nuk respektohen.

2. Kur shërbimi i monitorimit të konformitetit zbulon një devijim nga autorizimi i fluturimit, ofruesi i shërbimit të hapësirës U do të paralajmërojë operatorët e tjerë UAS që operojnë në afërsi të UAS-së në fjalë, ofruesit e tjerë të shërbimit të hapësirës U që ofrojnë shërbime në të njëjtën hapësirë ajrore dhe njësitë e shërbimeve të trafikut ajror përkatës, të cilat do të njihen me alarmin.

KAPITULLI V

CERTIFIKIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË HAPËSIRËS U DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË INFORMACIONIT TË PËRBASHKËT

Neni 14

Aplikimi për certifikatë

1. Ofruesit e shërbimit të hapësirës U dhe, kur caktohen, ofruesit e vetëm të shërbimit të informacionit të përbashkët duhet të mbajnë një certifikatë, të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, kur Shqipëria është vendi i tyre kryesor i biznesit.

2. Kur të jetë e zbatueshme, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, ofruesit e shërbimit të hapësirës U dhe, kur caktohen, ofruesit e vetëm të shërbimeve të informacionit të përbashkët që kanë vendin e tyre kryesor të biznesit, janë themeluar ose banojnë në një vend të tretë do të aplikojnë për një certifikatë në Agjencinë e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian ("EASA").

3. Certifikata e ofruesit të shërbimit të hapësirës U do të lëshohet në përputhje me aneksin VI.

4. Certifikata e ofruesit të shërbimit të informacionit të përbashkët do të lëshohet në përputhje me aneksin VII.

5. Certifikata do të përcaktojë të drejtat dhe privilegjet e mbajtësit të saj për të ofruar shërbimet me të cilat ka të bëjë.

6. Një aplikim për një ofrues të shërbimit të hapësirës U ose një certifikatë të ofruesit të shërbimit të informacionit të përbashkët, ose për një ndryshim në një certifikatë ekzistuese do të dorëzohet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga EASA-ja sipas rastit.

Neni 15

Kushtet për marrjen e një certifikate

1. Ofruesve të shërbimit të hapësirës U dhe, kur caktohen, ofruesve të vetëm të shërbimit të informacionit të përbashkët do t'u jepen certifikata nëse ata demonstrojnë se:

a) janë në gjendje të ofrojnë shërbimet e tyre në një mënyrë të sigurt, efikase, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në përputhje me operimet e synuara të UAS-së dhe në përputhje me nivelin e performancës të vendosur nga Autoriteti i Aviacionit Civil për



hapësirën U të hapësirës ajrore në përputhje me nenin 3(4);

b) përdorin sisteme dhe pajisje që garantojnë cilësinë, vonesën dhe mbrojtjen e hapësirës U ose shërbimeve të informacionit të përbashkët në përputhje me këtë rregullore;

c) kanë kapitalin e duhur neto në përpjesëtim me kostot dhe rreziqet që lidhen me ofrimin e hapësirës U ose shërbimeve të informacionit të përbashkët;

d) janë në gjendje të raportojnë ngjarjet në përputhje me pikën ATM/ANS.OR.A.065 në nënpjesën A, të aneksit III, të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”;

e) zbatojnë dhe mbajnë një sistem menaxhimi në përputhje me nënpjesën B të Aneksit III të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”;

f) zbatojnë dhe mirëmbajnë një sistem të menaxhimit të parrezikshmërisë në përputhje me pikën ATM/ANS.OR.D.010 në nënpjesën D, të aneksit III, të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre” dhe një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me aneksin II (Pjesa-IS.I.OR) të kërkesave për menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat dhe autoritetet, i zbatueshëm pas transpozimit të rregullores zbatuese (BE) 2023/203 në legjislacionin e brendshëm;

g) mbajnë për një periudhë prej të paktën 30 ditësh, informacionin dhe të dhënat e regjistruara operationale ose më gjatë, ku regjistrimet kanë të bëjnë me hetimet e aksidenteve dhe incidenteve derisa të jetë e qartë se ato nuk do të kërkohen më;

h) kanë një plan biznesi të fortë që tregon se ata mund të përmbushin detyrimet e tyre aktuale për të

ofruar shërbime në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë prej të paktën 12 muajsh nga fillimi i operimit;

i) kanë marrëveshje për të mbuluar detyrimet që lidhen me ekzekutimin e detyrave të tyre të përshtatshme për humbjen dhe dëmin e mundshëm;

j) kur ata përdorin shërbimet e një ofruesi tjetër shërbimi, ata kanë marrëveshjet e lidhura për këtë qëllim, duke specifikuar ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet tyre;

k) kanë zhvilluar një plan emergjence në rast ngjarjesh, duke përfshirë shkeljet e sigurisë që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve, të cilat rezultojnë në degradim ose ndërprerje të konsiderueshme të funksionimit të tyre;

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1, ofruesit e shërbimit të hapësirës U duhet të kenë një plan menaxhimi për emergjencat për të ndihmuar operatorin UAS që është në një emergjencë dhe një plan komunikimi për të informuar të interesuarit.

Neni 16

Vlefshmëria e certifikatës

1. Një certifikatë e një ofruesi të shërbimit të hapësirës U ose e një ofruesi të shërbimit të informacionit të përbashkët, do të mbetet e vlefshme për sa kohë që mbajtësi i certifikatës është në përputhje me kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Një certifikatë e një ofruesi të shërbimit të hapësirës U ose e një ofruesi të shërbimit të informacionit të përbashkët do të pushojë së qenë e vlefshme nëse mbajtësi i certifikatës:

a) nuk ka filluar operimet brenda 6 muajve pas lëshimit të certifikatës;

b) ka ndërprerë veprimtarinë për më shumë se 12 muaj rresht.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil ose Agjencia (EASA), sipas rastit, do të vlerësojë performancën operationale dhe financiare të një ofruesi të shërbimit të hapësirës U ose të një ofruesi të vetëm të shërbimit të informacionit të përbashkët nën përgjegjësinë e tij.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil ose Agjencia (EASA), sipas rastit, mundet, në bazë të rezultatit të vlerësimit të përmendur në paragrafin 3, t'i imponojë kushte të veçanta mbajtësit të certifikatës, të ndryshojë, pezullojë, kufizojë ose revokojë certifikatën.



KAPITULLI VI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Aftësitë e Autoritetit Kompetent

1. Autoriteti i Aviacionit Civil si autoritet kompetente do të ketë kapacitetin dhe ekspertizën teknike dhe operacionale për të përmbushur detyrimet e tyre sipas nenit 18. Për këtë qëllim, AAC-ja, duhet:

a) të ketë procedura të dokumentuara siç duhet dhe burime e përshtatshme;

b) të punësojë personel me njohuri të mjaftueshme, integritet profesional, si dhe përvojë dhe trajnim për kryerjen e detyrave të caktuara;

c) të ndërmarrë çdo veprim të kërkuar për të kontribuar në operime të parrezikshme, efikase dhe të sigurta ndaj ndërhyrjeve të paligjshme të UAS-së në hapësirën U të hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e tij.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të jetë në gjendje të marrë ose të iniciojë çdo masë të përshtatshme detyruese të nevojshme për të siguruar që ofruesit e shërbimeve të hapësirës U dhe ofruesit e vetëm të shërbimeve të informacionit të përbashkët nën mbikëqyrjen e tyre janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 18

Detyrat e Autoritetit të Aviacionit Civil

Autoriteti i Aviacionit Civil, do të:

a) krijojë, mirëmbajë dhe vërë në dispozicion një sistem regjistrimi për ofruesit e certifikuar të shërbimit të hapësirës U dhe ofruesit e vetëm të shërbimeve të informacionit të përbashkët;

b) përcaktojë se cilat të dhëna të trafikut, qofshin të drejtpërdrejta apo të regjistruara, ofruesit e shërbimeve të hapësirës ajrore U, ofruesit e vetëm të shërbimeve të informacionit të përbashkët dhe ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror duhet t'u vënë në dispozicion personave fizikë dhe juridikë të autorizuar, duke përfshirë frekuencën e kërkuar dhe nivelin e cilësisë së të dhënave pa cenuar rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale;

c) përcaktojë nivelin e aksesit në informacion për përdorues të ndryshëm të informacionit të

përbashkët dhe të sigurojë që ai të jetë i disponueshëm në përputhje me aneksin II;

d) sigurojë që shkëmbimet e të dhënave ndërmjet ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror dhe ofruesve të shërbimeve të hapësirës U të bëhen në përputhje me aneksin V;

e) përcaktojë mënyrën që personat fizikë dhe juridikë të aplikojnë për një ofrues të shërbimit të hapësirës U ose certifikatë të vetme të ofruesit të shërbimit të informacionit të përbashkët në përputhje me kapitullin V;

f) krijojë një mekanizëm për të koordinuar me autoritetet dhe entitetet e tjera, duke përfshirë në nivel lokal, përcaktimin e hapësirës U të hapësirës ajrore, vendosjen e kufizimeve të hapësirës ajrore për UAS brenda asaj hapësire U të hapësirës ajrore dhe përcaktimin e shërbimeve të hapësirës U që do të ofrohen në hapësirën U të hapësirës ajrore;

g) krijojë një program certifikimi dhe mbikëqyrjeje të vazhdueshme të bazuar në risk, duke përfshirë monitorimin e performancës operacionale dhe financiare, në përpjesëtim me riskun që lidhet me shërbimet që ofrohen nga ofruesit e shërbimit të hapësirës U dhe ofruesit e vetëm të shërbimeve të informacionit të përbashkët nën përgjegjësinë e tyre të mbikëqyrjes;

h) kërkojë nga ofruesit e informacionit të përbashkët dhe ofruesit e shërbimeve të hapësirës U, të vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm për të siguruar që ofrimi i shërbimeve hapësirës U të kontribuojë në funksionimin e sigurt të avionit;

i) kryejë auditime, vlerësime, hetime dhe inspektime të ofruesve të shërbimit të hapësirës U dhe ofruesve të vetëm të përbashkët të shërbimeve të informacionit siç përcaktohet në programin e mbikëqyrjes;

j) marrë parasysh nivelet e kërkuara të performancës së sigurisë kur përcakton kërkesat për çdo hapësirë U të hapësirës ajrore që i janë nënshtruar një vlerësimi të riskut të hapësirës ajrore siç referohet në nenin 3(1);

k) monitorojë dhe vlerësojë rregullisht nivelet e performancës së sigurisë dhe përdorë rezultatet e monitorimit të performancës së sigurisë, veçanërisht në kuadër të mbikëqyrjes së tyre të bazuar në risk.

l) krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me aneksin I (Pjesë-IS.AR) të kërkesave mbi menaxhimin e risqeve të sigurisë së informacionit me



një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat dhe autoritetet, i zbatueshëm pas transpozimit të rregullores zbatuese (BE) 2023/203 në legjislacionin e brendshëm.

ANEKSI I
KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E
KAPACITETEVE, KËRKESAT E
PERFORMANCËS, KUSHTET
OPERACIONALE DHE KUFIZIMET E
HAPËSIRËS AJRORE TË PËRMENDURA NË
NENIN 3(4)

A. Kriteret për përcaktimin e kapaciteteve të UAS-së dhe kërkesat e performancës

Për të përcaktuar aftësitë e UAS-së dhe kërkesat e performancës në përputhje me nenin 3(4)(a), Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Llojet e pritshme të operimeve të UAS-së dhe dendësinë e trafikut të drejtuar me pilot;
2. Klasifikimin dhe strukturat ekzistuese të hapësirës ajrore;
3. Shërbimet e hapësirës U që do të ofrohen;
4. Çdo kufizim tjetër shtesë.

B. Kriteret për përcaktimin e kërkesave të performancës së shërbimeve të hapësirës U

Për të përcaktuar kërkesat e performancës së shërbimeve të hapësirës U në përputhje me nenin 3(4)(b), Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Riskun në ajër dhe tokë;
2. Zonën gjeografike të tejmbushur;
3. Kushtet e njohura të rënda të meteorologjisë;
4. Disponueshmërinë e infrastrukturës që mbështet shërbimin U-space.

C. Kriteret për përcaktimin e kushteve operationale dhe kufizimeve të hapësirës ajrore

Për të përcaktuar kushtet operationale dhe kufizimet e hapësirës ajrore në përputhje me nenin 3(4)(c), Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë parasysh kriteret e mëposhtme:

1. *Kushtet operationale*
 - a) Llojet e pritshme të fluturimit;
 - b) Procedurat e emergjencës dhe kontigjencës për UAS-në;
 - c) Procedurën ndërmjet ofruesve të shërbimit të hapësirës U dhe njërive përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror për të koordinuar kërkesën për

autorizimin e fluturimit UAS në hapësirën ajrore të kontrolluar;

d) Procedurat për të shpërndarë konfigurimin dinamik të hapësirës ajrore në hapësirën ajrore të kontrolluar.

2. Kufizimet e hapësirës ajrore

- a) Kapacitetin e disponueshëm për trafikun UAS;
- b) Kapacitetin e disponueshëm dhe të planifikuar për operimet me pilot;
- c) Qasjen e avionëve të drejtuar me pilot në hapësirën U të hapësirës ajrore;
- d) Kufizimet meteorologjike për përdorimin e hapësirës U të hapësirës ajrore; Ndikimi në aerodrome dhe aktivitete të tjera specifike ngjitur me hapësirën ajrore të propozuar të hapësirës U.

ANEKSI II
PUBLIKIMI I INFORMACIONIT TË
PËRBASHKËT TË PËRMENDUR
NË NENIN 5(4)(A)

1. Ofruesit e shërbimeve të informacionit të përbashkët duhet të sigurojnë që informacioni i përmendur në nenin 5(1), (2) dhe (3) të jetë i disponueshëm në internet nëpërmjet teknologjive të përbashkëta të hapura, të sigurta, të shkallëzueshme, të qëndrueshme që janë në gjendje të mbështesin nivelet e kërkuara të disponueshmërisë dhe performancës, si dhe që sigurojnë ndërveprimin dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve hapësirës U në Republikën e Shqipërisë.

2. Ofruesit e shërbimeve të përbashkëta të informacionit do të japin akses në informacionin e përbashkët mbi baza jodiskriminuese.

3. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U dhe ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror do të përdorin një protokoll të përbashkët, të sigurt dhe të ndërveprueshëm të komunikimit të hapur mes tyre.

ANEKSI III
KËRKESAT PËR CILËSINË E TË
DHËNAVE, VONESËN E TË DHËNAVE
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE TË
PËRMENDURA NË NENIN 5(4)(B) DHE
NENIN 7(5)(C)

A. Për të përmbushur kërkesat e cilësisë së të dhënave, ofruesit e shërbimeve të përbashkëta të informacionit dhe ofruesit e shërbimeve të hapësirës U, duhet të sigurojnë që:



1. Cilësia e të dhënave do të ruhet;
2. Teknikat e verifikimit dhe vërtetimit përdoren për të siguruar që të dhënat të merren pa korruptim dhe që korruptimi të mos ndodhë në asnjë fazë të procesit të të dhënave;
3. Metadatat mblihen dhe ruhen.
4. Transferimi i të dhënave i nënshtrohet një procesi të përshtatshëm vërtetimi, në mënyrë që marrësit të jenë në gjendje të konfirmojnë që të dhënat ose informacioni janë transmetuar nga një burim i autorizuar.
5. Janë krijuar dhe mirëmbahen mekanizmat e veprimeve korrigjuese për raportimin dhe matjet e gabimeve.

B. Për të mbrojtur të dhënat, ofruesit e shërbimeve të përbashkëta të informacionit dhe ofruesit e shërbimeve të hapësirës U, duhet të:

1. zbatojnë politikat e sigurisë, duke përfshirë enkriptimin dhe mbrojtjen e të dhënave kritike;
2. mbrojnë protokollet e hapura të komunikimit të sigurt dhe të ndërveprueshëm nga ndërveprimet elektronike të qëllimshme të paautorizuara që mund të rezultojnë në një prishje të papranueshme të komunikimit;
3. identifikojnë, vlerësojnë dhe zbusin, sipas nevojës, risqet dhe dobësitë e sigurisë;
4. respektojnë standardet dhe rregulloret e sigurisë në lidhje me vendin ku mund të ruhen të dhënat dhe të sigurojnë që ofruesit e palëve të treta bien dakord të ndjekin praktikat e sigurisë;
5. përshkruajnë një politikë për ndërgjegjësimin dhe trajnimin e punonjësve dhe mjetet për të reduktuar rreziqet e brendshme, dhe mbrojtjen e të dhënave – duke përfshirë pronësinë intelektuale. Duke vepruar kështu, ata do të monitorojnë aktivitetin e përdoruesit dhe të rrjetit për të siguruar një pasqyrë të dobësive dhe kërcënimeve të ekosistemit.
6. vendosin zgjidhje që rrisin kapacitetet e inteligjencës, zbulimin e kërcënimeve dhe sigurojnë përdorimin e mbrojtjeve teknologjike.

ANEKSI IV

KËRKESA PËR AUTORIZIMIN E FLUTURIMIT TË UAS-it TË PËRMENDUR NË NENIN 6(4)

Kërkesa për autorizimin e fluturimit UAS do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

1. Numrin serial unik të avionit pa pilot ose, nëse avioni pa pilot është i ndërtuar privatisht, numrin serial unik të shtesës;
2. Mënyrën e operimit;
3. Llojin e fluturimit (operimet speciale);
4. Kategorinë e operimit të UAS-së (“e hapur”, “specifike”, “e certifikuar”) dhe certifikatën e klasit të avionit UAS ose tipit UAS, nëse është e aplikueshme;
5. Trajektoren 4D;
6. Teknologjinë e identifikimit;
7. Metodat e pritshme të lidhjes;
8. Qëndrueshmërinë;
9. Procedurën e aplikueshme emergjente në rast të humbjes së lidhjes së komandës dhe kontrollit;
10. Numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe, kur është e aplikueshme, të avionit pa pilot.

ANEKSI V

SHKËMBIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMACIONIT OPERACIONAL PËRKATËS NDËRMJET OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË HAPËSIRËS U DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË TRAFIKUT AJROR NË PËRPUTHJE ME NENIN 7(3)

1. Shkëmbimi i informacionit do të sigurohet nëpërmjet një marrëveshjeje për një nivel shërbimi që përcakton cilësinë e informacionit dhe nëpërmjet modelit të shkëmbimit të përdorur për të dhënat dhe informacionin përkatës operacional.
2. Modeli i shkëmbimit do të:
 - a) mundësojë menaxhimin dhe shpërndarjen e informacionit në format digjital;
 - b) përshkruajë veçoritë e informacionit të shkëmbyer, vetitë, atributet, llojet e të dhënave dhe ndërvlerësinë mes tyre;
 - c) përfshijë kufizimet e të dhënave dhe rregullat e validimit;
 - d) aplikojë një format standard të kodimit të të dhënave;
 - e) sigurojë një mekanizëm zgjerimi me anë të të cilit grupet e përdoruesve mund të zgjerojnë vetitë e veçorive ekzistuese dhe të shtojnë veçori të reja që nuk ndikojnë negativisht në standardizimin brenda dhe ndërmjet Shteteve Anëtare.
3. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U dhe ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror do të përdorin një metodë të njohur enkriptimi.
4. Ofruesit e shërbimeve të hapësirës U dhe ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror duhet të



përdorin një protokoll të përbashkët të sigurt dhe të ndërveprueshëm të komunikimit të hapur.

ANEKSI VI
CERTIFIKATA PËR OFRUESIN E
SHËRBIMIT TË HAPËSIRËS U REFERUAR
NË NENIN 14(3)

CERTIFIKATË PËR OFRUESIN E
SHËRBIMIT TË HAPËSIRËS U

[NUMËR CERTIFIKATE/LËSHIMI NR.]

Në bazë të urdhrimit të ministrit nr.../.... (dhe urdhrimit të ministrit nr .../....) dhe në varësi të kushteve të specifikuar më poshtë, Autoriteti i Aviacionit Civil certifikon:

[EMRI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT të
hapësirës U]

[ADRESA E OFRUESIT TË SHËRBIMIT
HAPËSIRËS U]

si ofrues i shërbimit të hapësirës U me privilegjet, siç renditen në kushtet e bashkangjitura të ofrimit të shërbimit.

KUSHTET:

Kjo certifikatë është e kufizuar në kushtet dhe qëllimin e ofrimit të shërbimeve të listuara në kushtet e bashkangjitura të ofrimit të shërbimit.

Kjo certifikatë është e vlefshme për aq kohë sa ofruesi i certifikuar i shërbimit të hapësirës U mbetet në përputhje me urdhrin e ministrit nr.../... dhe rregulloret e tjera të zbatueshme dhe, kur është e nevojshme, me procedurat në dokumentacionin e ofruesit të shërbimit të hapësirës U siç kërkohet nga urdhri i ministrit nr.../..., pjesa-....

Në varësi të përmbushjes së kushteve të mësipërme, kjo certifikatë do të mbetet e vlefshme nëse nuk është dorëzuar, kufizuar, pezulluar ose revokuar.

Data e lëshimit:

Nënshkruar:

[Autoriteti i Aviacionit Civil]

KUSHTET DHE KUFIZIMET E
DISPOZITAVE TË SHËRBIMIT U-SPACE

Ka marrë privilegjet për të ofruar shërbimet e mëposhtme të hapësirës U-Space nën kushtet dhe kufizimet e mëposhtme:

Shërbimet	Lloji i shërbimit	Kushtet	Kufizimet
Shërbimet e hapësirës U	Shërbimi i identifikimit të rrjetit		
	Shërbimi i gjeodërgjegjësisë		
	Shërbimi i autorizimit të fluturimit UAS		
	Shërbimi i informacionit mbi trafikun		
	Shërbimi meteorologjik		
	Shërbimi i monitorimit të përpuethshmërisë		
	Të tjera (siç përcaktohet nga AAC-ja)		

ANEKSI VII
CERTIFIKATA PËR NJË OFRUES TË
VETËM TË SHËRBIMIT TË
INFORMACIONIT TË PËRBASHKËT TË
PËRMENDUR NË NENIN 14(3)

CERTIFIKATË PËR OFRUESIN E
VETËM TË SHËRBIMIT TË
INFORMACIONIT TË PËRBASHKËT

[NUMËR CERTIFIKATE/LËSHIMI NR.]

Në bazë të urdhrimit të ministrit nr.../.... (dhe urdhrimit të ministrit nr/...), [Autoriteti i Aviacionit Civil] certifikon:

[EMRI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT TË
VETËM TË INFORMACIONIT TË
PËRBASHKËT]

[ADRESA E OFRUESIT TË SHËRBIMIT TË
HAPËSIRËS U]

si një ofrues i vetëm i shërbimit të informacionit të përbashkët.

Kjo certifikatë është e vlefshme për aq kohë sa ofruesi i vetëm i certifikuar i shërbimit të përbashkët të informacionit mbetet në përputhje me urdhrin e ministrit nr.../... dhe rregulloret e tjera të aplikueshme dhe, kur është e nevojshme, me procedurat në dokumentacionin e ofruesit të përbashkët të informacionit, siç kërkohet nga urdhri i ministrit nr.../..., pjesa-....

Në varësi të përmbushjes së kushteve të mësipërme, kjo certifikatë do të mbetet e vlefshme



nëse nuk është dorëzuar, kufizuar, pezulluar ose revokuar.

Data e lëshimit:

Nënshkruar:

[Autoriteti i Aviacionit Civil]

SHTOJCË

KLASAT E HAPËSIRËS AJRORE ATS DHE SHËRBIMET E OFRUARA NË HAPËSIRËN U

Qëllimi i kësaj shtojce është të tregojë shërbimet në lidhje me hapësirën U të hapësirës ajrore të ofruara në çdo klasë specifike të hapësirës ajrore në mënyrë koncize. Prandaj, ajo nuk ofron ndonjë

specifikim shtesë ndaj atyre të shprehura tashmë në këtë rregullore dhe urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.3.2023, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”. Shërbimet e trafikut ajror të ofruara nga njësitë ATS dhe kërkesat për fluturimet IFR dhe VFR mbeten ato të shprehura në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.3.2023, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror dhe të përmbledhura në shtojcën 4 të saj.

Klasa	Lloji i fluturimit	Lejohet në hapësirën ajrore të U-Space	Shërbimet në hapësirën U të Hapësirës ajrore nga USSP-të
A	Vetëm IFR	Jo pa rikonfigurim dinamik të hapësirës ajrore	
	UAS (1)	Po	Autorizimi i fluturimit UAS Informacion mbi trafikun në lidhje me UAS
B, C dhe D	IFR dhe VFR	Jo pa rikonfigurim dinamik të hapësirës ajrore	
	UAS (1)	Po	Autorizimi i fluturimit UAS Informacion mbi trafikun në lidhje me UAS
E	IFR	Jo pa rikonfigurim dinamik të hapësirës ajrore	
	VFR	Po, subjekt i ndarjes së pozicionit me USSP-të	Nil
	UAS (1)	Po	Autorizimi i fluturimit UAS Informacion mbi trafikun rreth UAS dhe VFR
F	IFR	Po, subjekt i ndarjes së pozicionit me USSP-të	Nil
	VFR	Po, subjekt i ndarjes së pozicionit me USSP-të	Nil
	UAS (1)	Po	Autorizimi i fluturimit UAS Informacion mbi trafikun rreth UAS, IFR dhe VFR
G	IFR	Po, subjekt i ndarjes së pozicionit me USSP-të	Nil
	VFR	Po, subjekt i ndarjes së pozicionit me USSP-të	Nil
	UAS (1)	Po	Autorizimi i fluturimit UAS Informacion mbi trafikun rreth UAS, IFR dhe VFR

(1) Përveç UAS-it që fluturojnë sipas Rregullave të Fluturimit Instrumental.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë